



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
NJËSIA E PROKURIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT(PARAPRAK)

Data: 15/01/2024

Drejtuar: “NELSA” shpk me adresë: Dajt Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1, Tiranë

Procedura e prokurimit: **Marrëveshjes Kuadër/ Procedurë e hapur e thjeshtuar, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

Numri i procedurës: **REF-91838-12-21-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje bukë, fruta, perime për kafshët e kopshtit zoologjik për vitin 2024**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.103, datë 26 Dhjetor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “MC Catering” shpk

NIPT-t: K72218022J

Vlera: **3 912 906** (tre milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtë) lekë pa Tvsh

2. “NELSA” shpk

NIPT-t: J71601012S

Vlera: **5 703 744** (pesë milion e shtatëqind e tre mijë e shtatëqind e dyzetë e katër) lekë pa Tvsh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “MC Catering” shpk

NIPT-t: **K72218022J**

arsyet e mëposhtme:

a) Në dokumentat e tenderit shtojca 7, “Kriteret e vecanta të kualifikimit” Pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik” përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedure prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:

2.3.6. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të depozitojë, ditën dhe orën e hapjes së ofertave, konfeksione – mostra për artikujt pellet ku të specifikohen qartësisht përbërësit e produktit, sipas specifikimeve më sipër. Ose, në rast të ofrimit të artikullit të pa konfeksionuar, të depozitojë një dokument vërtetues të përbërësve të produktit, sipas analizave të realizuara nga një laborator i certifikuar.

Në datën dhe orën e përcaktuar për hapjen e ofertave nga komisioni i vlerësimit të ofertave konstatohet se operatori ekonomik “M.C.Catering” shpk nuk ka paraqitur mostrat prane autoritetit kontraktor sikundër përcaktuar në pikën 2.3.6 të kriterëve të vecanta për kualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 dhe 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garanci kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin mostrat e produkteve të cilat duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “M.C.Catering” sh.p.k. nuk ka plotësuar kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik :
“NELSA” shpk, me Adrese: Dajt Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale
2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej:
5 703 744 (pesë milion e shtatëqind e tre mijë e shtatëqind e dyzetë e katër) lekë pa Tvsh,
është identifikuar si Oferta e suksesshme

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të
Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.